

Intervistë me albanologun Robert Elsie

MURI I HESHTJES ENDE RRETHON LETËRSINË SHQIPTARE

“Pas rrëzimit të diktaturës u zhdukën menjëherë edhe fondet shtetërore për të mbajtur gjallë institucionet dhe shkencëtarët. Kështu, në Shqipëri, shkencëtarët e moshuar dolën në pension dhe në varfëri të skajshme, kurse shkencëtarët e rinj u paraqitën për punë në sheshet e ndërtimit të Greqisë. Në Kosovë, edhe sot e kësaj dite, është shumë më e levërditshme të punosh rojë apo shofer për UNMIK-un se sa të kryesh një punë shkencore albanologjike,” kështu e vlerëson gjendjen e albanologjisë sot Robert Elsie.

Prishtinë, 23 Janar: Njihet si albanologu më i zellshëm në botë. Nuk merret vetëm me përkthime komerciale, por edhe me ato që jo vetëm se janë të rralla e shumë të vështira për t'u përkthyer. Albanologu Robert Elsie, përmes përkthimeve, ka berë që shumë autorë shqiptarë të flasin gjuhën angleze, mes të cilëve edhe këngët e kreshnikëve shqiptarë, por edhe ‘Lahutën e Malcis’ të At Gjergj Fishtës. Në këtë intervistë për ‘Kohën Ditore’, albanologu kanadez, Robert Elsie, flet për përkthimin e letërsisë shqiptare, për folklorin shumë pak të njohur shqiptar, për gjendjen e mjerë të albanologjisë dhe mundësitë e saja. Po ashtu, Elsie dëfton për idealizimin e përkthyesve të letërsisë shqipe të cilët nuk e kanë të lehtë të gjejnë përkrahje për punë e tyre.

[KD]: *Jeni njeri nga albanologët më produktiv sot. Së fundi përkthyet Këngët e Kreshnikëve e dihet që letërsia popullore shqiptare njihet pak në gjuhët e huaja. A mund të thoni se cila ishte shtypsa që ju nxiti t'i përvisheni një punë kaq të vështirë?*

[Elsie]: Në radhë të parë ishte pikërisht kjo arsye, fakti që këngët e kreshnikëve shqip ende njihen shumë pak në botën e jashtme. Këngët epike shqiptare dhe boshnjake kanë rrënjët e përbashkëta dhe lidhje të ngushta me njëra tjetrën. Këngët boshnjake njihen, të paktën nga specialistët botërorë, por këngët shqiptare ende jo.

Bota shkencore u habit jashtë mase në vitet ‘30 kur u zbulua që kishte ende këngëtarë epikë të gjallë në Evropë në traditën e këngëtarëve homerike të Greqisë së lashtë. Ishin shkencëtarët nga Universiteti i Harvardit, Milman Parry dhe Albert Lord, të cilët udhëtuan për në Ballkan në vitin 1934-1935 në kërkim të këngës epike, duke marrë me vete një aparat inçizimi. Ata brodhën Bosnjën, Sanxhakun, Malin e Zi, Hercegovinën dhe vise të tjera dhe hasën në kafenetë ballkanase lahutarë të cilët dinin të këndonin për Mujin dhe Halilin për orë të tëra pa tekst të shkruar. Profesor Parry, një ekspert për Homer, donte të dinte se si këngëtari arrinte të këndonte një këngë të gjatë pa e ditur tekstin përmendsh paraprakisht. Në bazë të punës shkencore mbi Homerin dhe të udhëtimit në Jugosllavi, ai përkufizoi teorinë e tij të ‘formulave të përsëritura,’ e cila shkaktoi një revolucion të vogël në hulumtimin e letërsisë gojore të këtij tipi.

Tepër interesant për mua dhe me siguri për shqiptarët është fakti se katër nga pesë këngëtarët që dolën në botimin e tyre e famshme: *Serbocroatian Heroic Songs* (Kembrixh & Beograd 1954,1955), ishin shqiptarë: Sali Uglanini, Xhemal Zogiq, Sulejman Makiq dhe Ali Fulanini. Këta pleq këndonin edhe boshnjaçe edhe shqip. Për atë, në zonën dygjuhësore të Novi Pazarit, ishte njësoj.

Shkencëtarët e Harvardit, Parry dhe Lord, kishin mësuar pak serbokroatisht për ekspeditën e tyre, por nuk dinin shqip, prandaj ata u përqendruan mbi materialin në gjuhën

serbokroate. Për këtë arsye, rrëfimi mahnitës për zbulimin e këngës epike në Evropë lidhet vetëm me Jugosllavinë. Mirëpo, kënga epike e këtij tipi, siç e dimë, ekzistonte edhe shqip. Vetë Parry dhe Lord kishin shënuar dhe inçizuar këngë shqip, dhe këto shënime dhe inçizime ruhen akoma në Harvard. Që prej punës së Lord-it, shumë pak njerëz jashtë Ballkanit kanë treguar një interes për këngët epike shqiptare - kuptohet, askush nuk dinte shqip -, kurse në Ballkan, puna e madhe e ndërmarrë nga shkencëtarët shqiptarë nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe nga Instituti Albanologjik në Prishtinë që nga vitet '60 për mbledhjen dhe për inçizimin e materialit, me pak përjashtime, nuk ka kapërcyer kufirin gjuhësor, pra u botua vetëm në gjuhën shqipe. Kështu, motërzimi shqiptar i këngëve të kreshnikëve ka mbetur i panjohur në botë e jashtëme deri me sot.

Duhet të theksohet se, tani, kënga epike sllave, si traditë e gjallë, është zhdukur, kurse kënga epike shqiptare ende jeton. Këngëtarët epikë të fundit në Evropë janë pikërisht lahutarët shqiptarë, brezi i fundit i tyre!

Kjo, në pak fjalë, ishte pikënisja e punës sime. Natyrisht libri im, *Songs of the Frontier Warriors*, botuar shqip dhe anglisht në ShBA në 2004, është vetëm një hap i vogël, por shpresoj se do të ketë ndikim. Nëse vëllimi jep ndihmesë për të zgjuar interesime për këtë fushë ose për kulturën shqiptare në përgjithësi, atëherë mund të thuhet se synimi kryesor është arritur.

[KD]: *A ekziston sot një potencial përkthyesish të cilët do ta krijojnë një panoramë me komplete për letërsinë shqipe në bote, që nga ajo popullore e deri te letërsia bashkëkohore?*

[RE]: Fare. Siç e dini, ka shumë pak të huaj që zotërojnë mirë gjuhën shqipe, dhe nga ata, ka vetëm një grusht të vogël njerëzish i cili do të ishte në gjëndje të përkthejë letërsinë shqiptare. Shtohet këtu fakti se, financiarisht, nuk mund të jetosh nga përkthimet letrare, kështu që ky grusht i vogël njerëzish doemos ka punë tjetër. Përkthyesit profesionalë në përditë janë zënë zakonisht me përkthimin e certifikatave, dokumentave gjyqësore etj, ku mund të fitojnë të paktën pak para. Kush merret me përkthime letrare përveç disa individualistëve që, në kohën e lirë, për idealizëm apo për arsye të tjera të pakuptueshme, përpiqen të vlerësojnë kulturën shqiptare në botë?

Prandaj, sipas meje, muri i heshtjes që e rrethon letërsinë shqiptare do të mbetet në vend për një kohë. Prapësërapri çdo vit dalin vepra të letërsisë shqiptare në përkthim: frëngjisht, gjermanisht, spanisht, italisht, greqisht, polonisht, hollandisht, bile herë pas here edhe anglisht. Për mua, çdo botim i tillë është një gëzim i madh.

[KD]: *Në një rast keni deklaruar se albanologjia ngjan me një dhomë të mbyllur dhe pa dritare. A po shkon albanologjia kah ngulfatja? Si të hapet dritarja?*

[RE]. Albanologjia, si çdo shkencë tjetër, duhet të financohet. Dihet se strukturat e albanologjisë u ndërtuan para disa dhjetvjeçarëve në kushtet e diktaturës komuniste. Pas rrëzimit të diktaturës u zhdukën menjëherë edhe fondet shtetërore për të mbajtur gjallë institucionet dhe shkencëtarët. Kështu, në Shqipëri, shkencëtarët e moshuar dolën në pension dhe në varfëri të skajshme, kurse shkencëtarët e rinj u paraqitën për punë në sheshet e ndërtimit të Greqisë. Në Kosovë, edhe sot e kësaj dite, është shumë më e levërditshme të punosh rojë apo shofer për UNMIK-un se sa të kryesh një punë shkencore albanologjike. Kuptohet se, në kushtet e tilla, është e vështirë të tërheqim studentë dhe kuadro të reja për një fushë që financohet shumë keq nga shteti. Që të punosh albanolog, duhet të jesh pak idealist. Megjithatë, për fat, ka ende disa njerëz të tillë.

Si të hapet dritarja? Ajo hapet pikërisht si çdo dritare tjetër në Ballkan - me para. Duhet më shumë fonde për arsimim, për të mbajtur gjallë dhe - e këtë e nënvizoj - sipas mundësive për

të përmirësuar institucionet ekzistuese. Të ju them të drejtën, kur hyj unë në Institutin Albanologjik në Prishtinë, mbushem zakonisht me një ndjenje ankthi apo trishtimi. Duket një ndërtesë pa jetë, dhe jo një qendër intelektuale e rëndësishme e popullit shqiptar. Dhe, para disa viteve, kur hyra për herën e fundit në Institutin e Gjuhësisë në Tiranë, kisha merak para së gjithash që ndërtesa të mos më shembej mbi kokë.

[KD]. *A mund të flisni për projektet tuaja në fushën e albanologjisë?*

[RE:] Kam ende disa libra albanologjike që presin dritën e botimit. Kështu, në Shtetet e Bashkuara po përgatitet një antologji tregimesh bashkëkohore shqiptare dhe një vëllim poetik i shkrimtarit kosovar Azem Shkreli. Së shpejti do të botohet në Los Anxheles një vëllim poetik i shkrimtarit Visar Zhiti. Në Angli kam dorëzuar për shtyp ‘Lahutën e Malcisë’ anglisht, por besoj se procesi botimor këtu do të pengohet nga mungesa e financimit. Është një vëllim i madh, dhe i shtrenjtë për t’u botuar. Kam edhe një histori të re të shkurtër të letërsisë shqiptare anglisht deri në vitin 2000, e cila mund të dalë gjithashtu në Angli. Ndërkohë merrem herë pas here me përkthime letrare, të cilat, për mungesë botuesi, i vendos në faqen time të internetit www.albanianliterature.com.

Intervistoi: Adem Abazi

[Botuar ne gazetën *Koha Ditore*, Prishtinë, 24 janar 2005, f. 17 / Published in the newspaper *Koha Ditore*, Prishtina, 24 January 2005, p. 17.]